



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 14.10.2024, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK**

1. Miratohet fillimi i procedurave të diskutimit publik lidhur me Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë.
2. Organizimi i diskutimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna.
3. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, diskutimi publik do të zgjatë 15 ditë kalendarike, nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtjen e konsultimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-060/01-135606/24, më 16.10.2024

**KRYESUES I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina

